

ARIAN LEKA

**POEZIA-MINIATURË NË GJUHËN SHQIPE
DHE SHKURTIMAT E XHEVAHIR SPAHIUT**

I.

Poezia - miniaturë në gjuhën shqipe

Miniaturat në vargje, këto forma të shkurtra e të stilizuara poetike, sprovuan prej kohësh shkrimtarët shqiptarë të cilën shfaqen herë në rolin e krijuesit të mirëfilltë, herë në rolin e mbledhësit, të përgatitësit për botim apo të përkthyesit të atij materiali poetik letrar, që i bindet “ligjit” të shkurtësisë. Edhe pse jo aq të shpeshta, sa mund të përbënin një dukuri ngulmuese, format e poezive të shkurtra kanë qenë të pranishme prej mëse një shekulli në krijimtarinë e disa shkrimtarëve shqiptarë.

Vlen të theksohet që në krye se kjo prani e poezisë me pak vargje në shqip nuk i brendashkruhet ndonjë lëvizjeje letrare, si minimalizmi për shembull, që mori hov në Amerikë mes viteve '60-'70 të shekullit të 20-të, si praktikë shkrimore me synime të qarta, që e vendosi veten qëllimshëm kundrejt llojit të gjatë të poemës romantike e realiste. Teknikat e mëvonshme shkrimore të poezisë miniaturë, ringjallur nga modernizmi si praktika shkrimore, mbetën të panjohura për shumë kohë në Shqipëri. Në këto bën pjesë edhe krijimtaria në poezi miniaturë e imazhistëve, shkruar në mes të viteve 1920-1930, me përfaqësues E. E. Cummings, W. C. Williams apo E. Pound e më pas prej brezit letrar *Beat*¹, të cilët sjellin risi dhe e pasurojnë modelin perëndimor të poezisë-miniaturë, përfshi edhe poezinë-fragment.

Duhet pohuar se në letërsinë shqiptare ka ekzistuar tradita e poezisë së shkurtër e të improvizuar, përhapur në forma orale nga *bejtarët*, traditë kjo e së njëjtës formë krijimi e përhapjeje si ajo e poezisë europiane të trubadurëve. Veç formave rituale, ajo është lidhur pas termave *bejte*, ndërkohë që poezia e shkurtër europiane nuk është emërtuar me ndonjë term të veçantë brenda shkrimit poetik, siç krijoi poezia e gjatë, për shembull, termin *poemë*. Ajo nuk ka krijuar as ndonjë zhanër më vete për vargjet e miniaturave poetike, por ka

¹ W. Pratt, *The Imagist Poem: Modern Poetry in Miniature*. “University of New Orleans Press”, Los Angeles, 2009, fq. 16-54.

përfshirë në to monostikun, epigramin, aforizmin, trioletën, limerikun etj., duke mbetur e hapur ndaj prirjeve dhe prurjeve të reja.

Togfjalëshin *bejtare popullorë* e ndeshin në artikullin “Ngjyra e vendit te Filip Shiroka”, nënshkruar nga Dr. Kolë Ashta, ku ai pohon ekzistencën e një shkollë poetike të tillë në Shkodër², sikurse edhe Gjergj Fishta në artikullin “Rrokull Shqipnisë”, ku shkruan se “me pasë për të qenë unë bejtar e me dashtë me shkruar ekloga, si Virgjili...”³.

Të shpjeguar si fjalë *bejtari* ndeshet edhe në fjalorë, si ai i Stewart E. Mann-it (1948), madje edhe në *Fjalorin e Arbreshëve t'Italis* të Emanuele Giordano-s. Në dallim nga bejtja autoriale, kjo quhet *bejte* folklorike, e ngjashme me *distikun* e që përmban dy vargje të rimuara, me natyrë satirike, a një “vjershë lirike a humoristike e thurur aty për aty”, siç shpjegohet në Fjalorin e gjuhës shqipe, por që gjithmonë emërton autorin e një poezie, vjershëtarin.

Duke u kthyer në arealin letrar shqiptar të poezisë së shkurtër vërehet se dhunti në punën letrare mbi këto forma të shkrimit janë qëmtuar ndër mjaft autorë, të cilët lanë krijimtari në format e epigramit, aforizmit, fabulave apo maksimave.

Nëse nuk ndalemi në fabulat me pak vargje të Santorit, të tilla si *I zoti e shërbëtori* apo *Pieshti e Teri*, mes ushtruesve të llojit të formave më të shkurtra letrare veçohet Lumo Skëndoja, përmendur nga Branko Merxhani përmes një artikulli të botuar në *Demokratia*, në mars të vitit 1932, në të cilin shkruhet se “ky njeri i nderuar dhe shëmbëlltor si në jetën praktike ashtu dhe në fushën e mëndjes, ka shkruar një herë këtë frazë shumë epigramatike: “PATRIOTISMEN LE T’A HETOJME NGA NDERGJEGJA JONË”. Këto fjalë të paka, të pastra e të ndritura si xhevahir, le t’i skalisi sikush nga ne në shpirtin e vetë.”⁴

Raste si i mësipërmi nuk shqyrtohen më tej në këtë punim, pasi në vëmendje të tij janë format e shkurtra poetike që organizohen sipas metrikës dhe jo posaçërisht çdo krijim i shkurtër, shprehur në formë mendimi, përfshi këtu aforizmat, epitafin, fjalët e urta, maksimat dhe vetë epigramin e lirë. Kjo kur ato nuk bëhen pjesë e praktikave prozodike që, prej elementeve të gjuhës, zgjedhin vetëm ato që shkaktojnë efekte akustike, të tilla si rimat apo ritmi e që sjellin ndikim edhe në përmbajtje të shkrimit poetik.

Po kështu, jashtë shqyrtimit të hollësishtëm mbetet këtu edhe prania e aforistikës ndër autorët shqiptarë, qoftë kjo edhe për rastet kur kritika letrare e

² Dr. Kolë Ashta, “Ngjyra e vendit te Filip Shiroka”, *Revista Letrare*, No. 5, Tiranë, 15 Prill 1944, fq. 1-2.

³ Gj. Fishta, “Rrokull Shqipnisë”, *Hylli Dritës*, No. 4, 1914/4, fq. 129.132.

⁴ B. Merxhani, “Rreth riorganizimit t’one arsimor”, *Demokratia*, Gjirokastër, 19 Mars 1932.

vëzhgon prirjen aforistike si tipar krijimtarie të ndonjë autori, si Migjeni. Për idetë e tij është theksuar se kanë prirjen të jenë “herë të pshtjellueme, shpesh herë të shprehuna prej njëj pikëpyetjeje, herë të tjera të përmbledhuna në një frazë si aforizma”⁵, sikurse vëren Qemal Draçini. Raste të tilla nuk merren në shqyrtim pasi, në vëmendje të punimit, siç u shpreh, janë format e shkurtra poetike, të organizuara sipas metrikës.

Duke qëmtuar zanafillat e formave të shkurtra të krijimtarisë mirëfilli poetike vërehet se ato trashëgjuan prej tradicionales elementet e veçanta që Kristë Maloki i cilëson si të shfaqur herët “ner do vjershname dhe kallxime popullore” dhe që prejardhjen e kanë nga vargëzimi i ritualeve, sikurse edhe “nër vallet e këndueme dhe të këcyeme të popullit”, të cilat ishin dëgjuar “ner festa e argtime të fshateve e të maleve nga kangët e bejtaxhijve të mirënjoftunë...”⁶.

Mes këtyre, përmendim, duke i lënë jashtë shqyrtimeve të mëtejshme e më të hollësishme, disa prurje me vlerë poetizimi me prejardhje nga ritet e ringjalljes së natyrës, ritualet e urimit, ritualet me natyrë magjike apo praktikat e eufemizmave etj., të tilla si vargëzimi kushtuar kultit të gjarprit, ku ndeshen vargjet: “O zoti i arës / lëshoja tokën farës” etj., e ku format e shkurtra të poetizimit janë gjithmonë të pranishme.

Përpara se t’u qasemi të dhënave që ofrojnë praktikat e kulturave të tjera lidhur me formën e shkurtër të të shprehurit poetik, vëzhgojmë disa prurje që marrin në shqyrtim çështje të tilla si elementi i shkurtësisë, duke ngritur pyetjen nëse kjo dukuri është një tipar i brendshëm dhe i qenësishëm i traditës së hershme të vargëzimit shqiptar apo kemi të bëjmë me pikëtakime, të qëllimshme a të rastit, me tradita kulturore të tjera, kufitare apo më të largëta me traditën e shkrimit shqip.

Në artikullin me titull *Për gjenezën e literaturës shqipe*, teksa shqyrton elemente të metrikës në kulturat ballkanike, Eqrem Çabej vëren se përsa i përket formës, te shqiptarët “parasundon... shkurtësia dramatike e këngëve”. Duke e thelluar në metodologji krahasimtare vëzhgimin e tij, Çabej vëren edhe se, krahasuar me “gjerësinë epike dhe frymën elegjike të këngëve serbe, rreptësinë e shpesh të këngës bullgare, retorikën dhe një farë mburrje të këngës greke, mallin e pacaktuar të këngës rumune, karakterin konkret e realist të ftohtë të këngës aromune”, “shkurtësia dhe mbarimi i përnjëhershëm” janë tipare të veçanta për këngën popullore shqiptare, duke e vënë theksin te substrati vendas e jo te ndikimet apo shkëmbimet, jo të panjohura e të pamundura ndër kulturat kufitare.

Po aty vërehet se elemente të tilla nuk janë veçanti e një areali të izoluar,

⁵ Q. Draçini, “Vepra poetike e Migjenit”, *Fryma*, Shkodër, 1944, Nr. 3, f. 110.

⁶ K. Maloki, “A asht poet Lasgush Poradeci?”, *Përpyjekja shqiptare*, No. 18-24, Tiranë, 1938, f. 350.

pasi ato i gjen edhe te arbëreshët në Itali, te të cilët “metrika karakterizohet me verse të shkurtra pa rimë, ritmi i se cilave rrjedh nga një periodë e caktuar e metrikës popullore shqiptare”.⁷

Përveç “shkurtësisë dhe mbarimit të menjëhershëm”, elemente të tjera të pranishme në prozodinë tradicionale shqiptare janë fragmentarizmi dhe përshkrimi i ngjarjes “me një sy realisti o të një kronisti”. Duke studiuar poetikën e shqiptarëve Kolë Ashta e vëzhgon praninë e fragmentit dhe punën e kronikanit në grupin të kënduarit të “emnuem terthorçe o mbaje krahi”, në të cilat gjenden “kangë të shkurta ndër tetrroksha”, që shfaqen si pjesë e “epopës fragmentare”⁸, siç e përmyll analizën e tij Çabej.

Po aty, në përpjekje për të krijuar një përfytyrim sa më të plotë mbi burimet dhe rrjedhat e poezisë së shkurtër apo miniaturës poetike në kultura të ndryshme, vërehet se, përveç amave të traditës, si paraardhje dhe pjesë e edukimit poetik, të cilin tradicionalisht shqiptarët e kanë marrë që herët, në formën e të “vetëmit ushqim poetik i vjetve fëmijore”⁹ (ardhur përmes praktikave të ritualeve pagane, këngëve të djepit, përrallave, gojëdhënave, gjëzave, vargjeve të krijuara prej fëmijëve me meloditë e tyre monotone) në modelimin e formave të shkurtra poetike ndihet edhe prania e asaj tradite shtegtuese, si pjesë e letërsisë së hershme fetare, ardhur në formën e thënieve, profecive, enigmave, mistereve, psalmeve, orakullimeve, këngëve-himne apo proverbave shfaqur, mes të tjerash, pos formave gojore, në *Meshar* edhe në *Fjalorin* latinisht-shqip të Frang Bardhit.

Të dhëna me vlerë në lëvrimin e formave letrare të vargjeve epigramatike, sentencës dhe aforizmës etike të traditës shqipe, herë me elemente të prozodisë e herë jo, mbërrijnë, mes të tjerësh edhe nga Shtjefën Gjeçovi, botuar te *Agimi i gjytetniis*.

Ndonëse ka dhënë më shumë, Gjeçovi tregohet i përkorë, teksa i njeh vetes veç të drejtën e mbledhësit dhe sjellësit të materialit, siç shënon, por jo edhe autorësinë e kësaj krijimtarië. Lidhur me këtë ai shkruan “... se gjaa prejë vedit nuk qita n’kto pak rreshta, por veç çka mora uhaa prejë tjerësh”, me të cilin ai hap kushtimin me titull “Shqyptar t’dashun!”¹⁰

⁷ E. Çabej, “Për gjenezën e literaturës shqipe”, *Hylli i Dritës*, No. 3-7, Shkodër, 1939, fq. 156-175.

⁸ K. B. Ashta, “Prolusjoni i «Epikës Popullore» në katedrën e Gjuhës Shqipe në Romë nga Prof. E. Koliqi”, *Hylli i Dritës*, No. 3-7, Shkodër, 1939, f. 347.

⁹ E. Çabej, artikull i cituar, f. 177.

¹⁰ A. Shtjefni Konstandini Gjeçov, *Agimi i gjytetniis*, Shtypshkronja “NIKAI”, Shkodër, 1910, f. 15.

Duhet theksuar me këtë rast se, disa elemente të ritualistikës në poetikën shqiptare, përfshi edhe një “humor çlirimtar dhe shembues”¹¹, i krijuan më vonë poezisë së shkurtër shqiptare mbështetjen e nevojshme në rrugëtimin e saj drejt kalimit nga areali ritual rural drejt rritjeve të qytetit.

Në periudhën pas Pavarësisë janë gjurmuar krijime autoriale, që shquhen për tipare më të plota të poezisë-miniaturë, shkruar në zhanrin e epigramit të shkurtër satirik. Të tilla janë vargjet e poetit rilindës Loni Logorit. Përmes shtatë radhëve, nën titullin *Epigramë*¹², botuar në *Kalendarin kombiar*, Logori sjell një formë të shkurtër e të arrirë të poezisë retorike.

Pas nëntitullit “Tërmeti në Durrës dhe plani i ri i qytetit”, që luan rolin e kushtimit, përmes humorit të mprehtë dhe befasisë, tipike për epigramin klasik, autori dëshmon njohje të skemave metrike dhe zotësi në përpunimin e një sistemi të veçantë rimash, siç është ai i llojit AA-B-CCC-B, si organizim i një skeme prej tri ritmesh, që sjellin modelim të veçantë tingullor:

Me vendim të qeverisë
Jipet’ urdhrë perëndisë:
Të pushojë tërmetin!
Se për të rrëzuar
Dhe për të shkretuar,
- Kemi emëruar
Inxhinjer Shkanjetin.

E pasur në struktura të poezisë së shkurtër paraqitet edhe poezia e Ndje Mjedës, sidomos ajo pjesë e saj, që studiuesit e kanë klasifikuar si “letërsi për fëmijë”, në të cilat, si pjesë e emërtimeve “Kashë e lasha”, mes vargëzimeve prej katër e gjashtë vargjeve, ndeshim struktura të ndryshme ritmesh e rimash, si në poezitë “Era”, “Jehona”, “Rrëfeja”, “Hana”, “Qiriu”, “Kova”, “Ora e murit”, “Nderoni pleqninë”¹³ etj.

E veçantë dhe e pasur me tekste poetike si miniatura shfaqet edhe krijimtaria e Hamid Gjylbegajt në fillim të viteve ’30. Vargëzimi i tij ofron material të begatë, që mbahet fort pos teknikave shkrimore të tradicionales në vjershërim. Tek ky autor mund të kërkohet e gjendet një paraprijës në lëvrimin e formës klasike të miniaturës poetike shqiptare të cilat, edhe kur nuk kanë formë epigramatike, ruajnë tiparet dhe përcjellin shpirtin dhe unitetin epigramatik, pasi funksionojnë si struktura të vetëmjaftueshme, të mbyllura

¹¹ K. Maloki, *po aty*.

¹² L. Logori, *Epigramë*, “Kalendarin kombiar për motin 1928”, Volumi i Njëzetë e Dy, Drejtonjës Lumo Skëndo, Botuarë prej Kristo P. Luarasi, Tiranë, f. 88.

¹³ N. Mjeda, *Guxo* (vjersha për fëmijë), Shtëpia Botonjëse “Naim Frashëri”, Tiranë, 1953.

brenda formave të veta dhe të dallueshme nga format e tjera poetike të këtij autori.

Dëshmi për këtë janë epigramet me natyrë filozofiko-mistike të botuara në formë parateksti në vepra të tilla si “Fjala e Virtytit” (1929), “Monumenti i Atdheut” (1930), “Fletra e Jetës: Pasqyra e së vertetë vërtetës” (1932), “Agimi i filozofis” (1933), “Çikrrime filozofie” (1934) apo “Kuvendi i Shqiptarit” (1934) etj.

Prirja e Gjylbegajt ndaj formave të shkurtra të poezisë nuk këqyret vetëm në këto paratekste, ku gjithsesi spikasin, pasi forma të tilla shfaqen në të gjithë krijimtarinë e këtij autori. Si shembull mund të shërbejnë poezi të tilla si *Vrejta* dhe *Fundi*¹⁴, botuar në “Kuvendi i shqiptarit”, sikurse paraqiten këto rrjedha mendimesh të disiplinuar përmes metrikës:

VREJTJA

Kopja me origjinalin,
Asht si fusha me malin;
Por, kjo përrallë kâmbë çale
Asht fjeshtë origjinale!...

FUNDI

Fundi i fundit të fundit,
Asht kjo fjala e ktij kërcûnit:
Se inxhi nepër kasapë,
Kurr nuk shiten more babë!

Me të tipare të tilla vijjnë edhe katërvargëshet monostrofike, botuar në “Çikrrime filozofie” (1934) dhe nënshkruar herë me “Varfa” dhe herë me “Varfa i shqiptarve”¹⁵:

N’ kjoftë virtyti për t’ vertetë,
Me bâm flijë vetvedin vetë;
Kje, e âsht edhe do t’ jetë,
Jezu Krishti fjalë e drejtë!...
VARFA

Kalleptë e rí e kalleptë e vjetër,
N’ filozofi s’ janë kurgjâ tjetër;
Veç si fjalët pukë e pykë,
Qi t’ dyja dalin fill m’ një grykë!
— *Varfa i Shqiptarve* —

¹⁴ H. Gjylbegaj, *Kuvendi i shqiptarit*, Shtypshkronja “Gutenberg”, Tiranë, 1934, f. 16.

¹⁵ H. Gjylbegaj, *Çikrrime filozofie*, Shtypshkronja “Gutenberg”, Tiranë, 1934, f. 1, 4, 11.

Duke vërejtur se çështja e poezive miniaturë apo e trajtave të llojit minimalist të poezisë në krijimtarinë e Hamid Gjylbegajt meritojnë trajtim të mëvetësishëm, objekt ky që e tejkalon qasjen e këtij punimi, shtojmë gjithashtu se, ndonëse jo të përputhura me formatin, trioleta, si trajtë e poezisë së shkurtër, në gjuhën shqipe është shkruar edhe nga Lasgush Poradeci.

Si shembull për këtë vlen poezia me titull “Trioleta”, botuar te “Vallja e Yjeve” (1933) ku, në dukje të parë, më fort sesa poezia e shkurtër, dëshmohet njësia poetike prej tri pjesësh me nga dy strofa të rimuara secila.

Përtej tetë vargjeve të lexueshëm, autori shkruan një poezi minimaliste, pasi forma strikte e trioletës kërkon që vargu i parë të përsëritet në vargun e katërt dhe në vargun e të shtatë, ndërsa vargu i dytë të përsëritet edhe në vargun e tetë e përfundimtar të trioletës.

Kështu që, përmes trioletave të tij Lasgush Proradeci sjell një profil jo fort të vënë re nga studimet letrare, atë të një autori paraardhës në shkrimin e llojit të poezive minimaliste-miniaturë të afërt me formën e rondosë. Kjo pasi, në të vërtetë, trioletat e këtij autori, sikurse e kërkon forma, kanë vetëm pesë vargje të rinj e origjinalë, pasi, ndërkohë të tjerët përsëriten, sikurse, përsëritet bashkë me to edhe skema ritmike dhe pesë rimat e strukturës-lojë AbaAabAb ku shkronjat e mëdha tregojnë vargjet dhe rimat e përsëritura.

Meqë në krijimtarinë e këtij autori janë disa trioleta, mes të tjerash *Ah! Me atë mall që më ke ti, Mbretëria jonë*¹⁶, si shembull vjen vetëm *Trioleta*.

I
Pik’ e loteve të mija
Vetëtin si gur i rrallë
Shkrep me zjarr posi shkëndija
Pik’ e loteve të mija.

Bukurija, bukurija
Më pat puthur mun në ballë:
Pik’ e loteve të mija
Vetëtin si gur i rrallë.

II
Si m’u ndrit çdo mall që pata!
Miq, o! kim’a-ni zilinë!...
Ardhi dita: iku nata -
Si m’u ndrit çdo mall që pata!

¹⁶ Për më shumë rreth argumentit shih: L. Poradeci, *Vepra letrare: Trioleta Mbretëria jonë*. “Naim Frashëri”, Tiranë 1990, f. 111, f. 120-121, f. 126-127.

Varg-e-varg me përgjërata
 Para sysh më venë-e-vinë...
 Si m'u ndrit çdo mall që pata!
 Miq, o kim'-ani zilinë.

III
 Këto kopshte ku fryn era
 Muar gjyrën e floririt...
 Se ç'm'i shkel baluke-prera
 Këto kopshte ku fryn era:

Parëvera! parëvera!
 Po më çel në mes të gjirit –
 Këto kopshte ku fryn era
 Muar gjyrën e floririt.

Prej këtej, Lasgush Poradeci mund të studiohet jo vetëm për “formën mashtruese” të tiroletave, si poezi minimaliste, por edhe për të tjera, që i plotësojnë mirëfilli rregullat fikse të poezisë së shkurtër epigramatike, mes të cilave këtij autori mund t'i përmendet tercina me strukturën strofike 2+1 të rimuar sipas skemës AAA, *Prej çdo gaz-i e hidhërimi*.

Rast për vëzhgim mund të përbëjë edhe një *rondel*, si “Përçafimi”, në të cilin raporti varg i ri / varg përsëritës nuk paraqitet si të trioleta, por shkurtesa përmes përsëritjes së pesë vargjeve jep shkas për interpretim.

Por, nëse te format e përmendura më sipër, te Hamid Gjylbegaj do të shihnim një pararendës klasik të poezisë-miniaturë dhe njohës e përdorues të formave të shkurta të klasicizmit tradicional poetik lindor, një ndër përfaqësuesit e spikatur të poezisë së shkurtër moderne do ta gjenim te Martin Camaj. Midis këtyre dy autorëve, përfshihen disa krijime, gjithashtu në formë të shkurtër poetike të Nonda Bulkës, të cilat autori i ka quajtur “rubai”.

Ndryshe nga rubaia klasike, që i drejtohet kryesisht temave universale, ekzistenciale e lirike, “rubaitë” e Nonda Bulkës bëjnë dallim nga modeli pasi kanë karakter politik dhe, nga ana e strukturës formale, ruajnë formën katërvargëshe, por jo edhe sistemin metrik dhe rimat e llojit AABA.

Në disa “rubai” politike, si për shembull “Rubai për Zogollin”, ai braktis tematikën, por i mbetet besnik skemës rimore AABA, sikurse vepron edhe në “Rubaitë zamanit”. Po ashtu ai operon edhe në ndonjë nëntitull rubali, si te “Nisja”, pjesë e “Rubai për parashutistët”, ndërkohë që te rubai të tjera si,

“Rubai për Çurçillin”, “Rubai për të prekurin”, “Rubai për të damkosurit”, Nonda Bulka përdor kryesisht skemën rimore AABB.¹⁷

Për të shkuar në brendësi të modernes dhe rastit Camaj, si shembull mund të merret poezia me titull *Përgjigja e jehonës*, botuar në vëllimin poetik “Njeriu më vete dhe me të tjerë” (1978). Fjala, vargu dhe organizimi strofik i këtij krijimi nuk e shmang thelbin e traditave të ritualit të trashëguar, por përmes ndjenjës së eksperimentit dhe të lojës, në aspektin tingullor e semantik, ai shfaq njëkohësisht edhe shpirtin modernist të avangardave. Ky krijim ofron edhe një plastikë të zhvilluar ndaj formave dhe riorganizim të mjeteve metrikës, për sa kjo formë miniature lejon:

Zemër, vedër e gdhendun në gurë, ti! – “Urti!”
Flokë-gjog, me sy ndër vasha të reja! – “Eja!”
Mos u trenò mbas gazit të pafaj, poet! – “Et!”
Erë e djegun për vesë mbi bar! – “Ar!”

Në muzg te mali i shurdhë, mos prit! – “Prit!”¹⁸

E nëse Qemal Draçini kishte vërejtur te Migjeni prirjen ndaj aforistikes, Arshi Pipa, në “Letërsia bashkëkohore shqiptare”, botuar në Nju-Jork, më 1991, thekson prirjen ndaj fragmentares te Martin Camaj. Duke shqyrtuar vëllimin “Njeriu më vete e me të tjerë”, Pipa thekson se gjuha e Camajt në këtë libër është “jashtëzakonisht eliptike dhe madje e fragmentuar, shpërfill të kuptuarit”. Prirja drejt fragmentares është pohuar edhe nga vetë Camaj, kur shprehet se “krijimi im letrar ka diçka fragmentare në vetvete”.

Ndërkohë, teknika e fragmentit, dëshira për eksperiment, intimiteti dhe “humori çlirimtar dhe shelbues”, si dhe hapja ndaj së befasishme, habisë, të nënkuptuarës, “të pshtjellumes”, që ndeshen tek Migjeni, thellohen te Camaj, sikurse dëshmon poezia dyvargëshe *Karakter*, botuar në ciklin *Dorëshkrime, variante*, strukturë që, edhe pse jo besnike e prozodisë strikte të dyvargëshit (heksametër dhe pentametër), arrin ta krijojë distikun epigramatik.

Sytë e saj me kjartësi qiellore
shëndrisin para bukurinave.¹⁹

Ndërkaq, letërsia shqiptare e shkruar në Kosovë gjën përmes Din Mehmeti, dalluar për “përpikmëri eliptike” dhe Rrahman Dedaj, i njohur për

¹⁷ Shih: N. Bulka, nga “Vargje satirike”, 1951: *Vepra letrare* 3, f. 129, 144, 146, 147-149, 150-151, Shtëpia botuese “Naim Frashëri, Tiranë, 1980.

¹⁸ M. Camaj, *Njeriu më vete dhe me të tjerë*, “Onufri”, Tiranë, 2021, f. 74.

¹⁹ Shih: M. Camaj, *Vepra* 9, “Onufri”, Tiranë, 2010, f. 167.

“struktura eliptike të disiplinuar”, siç i cilëson ata studiuesi Robert Elsie, përmes Ali Podrimjes dhe veçanërisht përmes Azem Shkrelit, disa përfaqësues të spikatur të poezisë së shkurtër të formave sentencë e miniaturë.

Përveç të tjerëve, një shembull i këtyre formave poetike vjen përmes krijimtarisë së spikatur të Azem Shkrelit.

Libri me poezi të zgjedhura “Pagëzimi i fjalës” i këtij autori shërben si një antologji e vogël brendashkruar vëllimit, në të cilin ruhen kronologjia dhe tematikat më të dallueshme që ky autor ka përpunuar në lërimin e këtij “zhanrin” e distikut epigramatik.

Përveç poezisë me titullin *Vargje*²⁰, e cila prin vëllimin, aty dëshmohen edhe gjurmë të tjera të ushtrimit në këtë formë të lashtë të poezisë së shkurtër epigramatike, të tilla si poezia me numrin 7, e fundit në ciklin *Të thjeshta*, shkruar në dyvargësh-distik dhe organizuar me një rimë të brendshme foljore:

Sa poshtë që paskam zbritur
Duke u ngjitur këtij Olimpi t’rrejshëm.²¹

Me teknikën e distikut, por të rimuar tashmë në skajet e vargut, si një kuplet, është realizuar edhe poezia *Gjykata* e cila, veç cilësive të miniaturës poetike, ruan edhe tiparet e fragmentit, që e bën këtë tekst të tingëllojë si pjesë funksionale e një forme më të zgjeruar e të humbur, prej së cilës ka mbijetuar vetëm dy distik:

Dhe mjerë ato madhëri që u rritën në pup
Nga ëndja e tyre t’u rrinë të tjerëve mbi sup.²²

Modele të kësaj prozodie me metrikë të rregullt, që funksionojnë si një mendim i shprehur në dy çifte vargësh, apo si një njësi e vetme me dy vargje, bëhen më të shpeshta dhe përfaqësuese në poezinë e Azem Shkrelit, të tilla si distiku metrik *Njerëzit*:

Sikur të takoheshim me vetveten sy më sy
do të putheshim apo kishim për t’u pështy?²³

apo *Zjarrmia* që, duke braktisur aftësinë metrike, zbaton forma të tjera eksperimentale të trevargëshit apo katërvargëshit, herë strofik e herë si distik i

²⁰ A. Shkreli, *Pagëzim i fjalës*, “Rilindja”, Prishtinë 1981, f. 23.

²¹ *Po aty*, f. 38.

²² *Ibid.*, f. 56.

²³ *Ibid.*, f. 118.

dyfishuar, duke i paraqitur këto njësi vetëfunksionuese parësore si një praktikë që kishte zënë vend dhe që konsoliduar si formë poetike e krijimtarisë së tij.

Tash sa kohë
Po don të gdhijë
E s'po mundet²⁴

Kjo teknologji formash poetike konceptuale dhe eksperimentale njëherazi, është përdorur si mjet efikas retorik mes autorit dhe lexuesit. Të tilla janë *Mordja* dhe *Porosia*, poezi këto të organizuara sipas modelit me dy distikë. Në poezinë e parë zhvillohet sistemi i rimave AA BB:

Endet nëpër ne dhe na krijon në çdo pore
Varre të cilat shemben ose përmendore

Porse mbi dhunë të saj ne kemi një dhanti:
Ajo di t'marri, ne – edhe t'krijojmë njeri.²⁵

ndërsa në të dytën dyvargëshi i parë rimon dhe i dyti mbetet në nivel asonancash:

Mos e ndy fjalën, biro, se pastaj
Kot e ke t'falesh para lëterit të saj

Më ka pas thanë një njeri i urtë me thinja
Nuk di a rron a vdiq nga mençuria²⁶

Model tjetër i poezisë së shkurtër të Azem Shkrelit është edhe katërvargëshi strofik *Vegim i verdhë*, organizuar sipas ndërthurjes së rimave ABBA, si një strukturë e zgjeruar e distikut epigramtik:

Parandjenjë e ligë, vallë përse je
Kaq e marrë? Unë dhunët e tua i di
Ndaj dhe këtë pikë helmi buzagaz ta pi
Sado që për të vdekë ende s'kam le.²⁷

Midis këtyre modeleve dhe praktikave shkrimore të poezisë-miniaturë

²⁴ Ibid., f. 129.

²⁵ Ibid., f. 65.

²⁶ Ibid., f. 76.

²⁷ Ibid., f.131.

vendosen edhe “shkurtime” e poezive të Xhevahir Spahiut të cilat arrijnë të ruajnë prej modeleve paraardhëse kodin ligjërimor por, nga ana tjetër, ato shfaqin edhe risi, duke bërë të vetat tiparet e “poezisë minimale” të modernistëve të mesit të shekullit të 20-të, me të cilën kjo poezi përkon, qoftë edhe spontanisht.

Një mënyrë për të kuptuar se një formë poetike zë vend brenda një kulture është shkrimi i saj prej përdoruesve të tjerë bashkëkohës apo pasardhës. Në këtë rast, të shkruarit e “shkurtimeve” nga të tjerë autorë dëshmon pranimin e “zhanrit” dhe përlijjen dhe ngulitjen e termit, sikurse ndodh me poetin Ilirjan Zhupa që, në librin e tij me titull “Të gjallë dhe të vdekur”, përdor poezitë - shkurtime.

Prani e formave të krijimtarisë - miniaturë përmes përkthimeve në shqip

Përveç autorëve vendas, që punuan me format e shkurtra të poezisë autoriale të shkruar në gjuhën shqipe, rol ndikues në zhvillimin e llojit letrar të miniaturës poetike dhe të formave të tjera letrare, që plotësojnë kushtin e shkurtësisë, luajtën përkthimet.

Përmes shqipërimeve, këto forma lakonike të të shprehurit poetik u bënë, deri diku, pjesë e kulturës leximore mes viteve 1920-1930, sikurse dëshmohet nga publikimet në shtypin letrar dhe disa botime të tjera të përveçme.

Një prej këtyre është libri prej 64 faqesh, me titull *Këtu – këtë*²⁸, përgatitur për botim nga Gaçe Ballo dhe Petro Garo, në të cilin, krahas rrëfenjave popullore, anekdotave, novelave, tregimeve, komedive me një akt, konkurseve, *gjë a gjëzave* apo vargjeve të ndryshme, gjenden edhe krijime të tilla epigrami apo forma të ngjashme me poezinë e shkurtër, të tilla si “Këshilla të mira” apo “Mentime”.

Prani e praktikave shkrimore të poezisë së shkurtër pasurohet si kulturë njohjeje përmes leximit edhe nga të tjera publikime, siç dëshmon botimi me titull *Epigrame dhe aforizma nga disa njerz të çquar*, përgatitur nga Kostaq V. Steffa. Vetë titulli i botimit tregon se vepra përmban thënie, aforizma dhe epigrame, që përmbushin ligjësitë formale të shkrimit të poezisë së shkurtër.

Botimi bën bashkë emra të njohur të historisë, shkencës dhe letërsisë, të tillë si Napoleoni, George Bernard Shaw, Henry David Thoreau, Thomas Henry Huxley dhe Oscar Wilde²⁹, disa prej tyre të sprovuar në të shkruarin e formave të shkurtra të krijimit.

²⁸ Shih: *Këtu – këtë, përmbledhur e përgatitur* për botim nga Gaçe Ballo dhe Petro Garo, “Shtypshkronja E. Vassiliadhi”, Stamboll, 1924.

²⁹ K. V. Steffa, *Epigrame dhe aforizma nga disa njerz të çquar*. Shtypshkronja “Teknike”, Tiranë, 1930.

Një vepër e botuar rreth atyre viteve është edhe vëllimi me titull *Mendime dhe aforizma bektashijsh të vjetër*, sjellë prej Baba Ali Tomorit në formën e një përmbledhjeje dhe përkthimesh.³⁰ Veç dëshmive të tjera, ky libër ka vlerë pasi, praktikisht perëndimore të shkrimit, pasurojnë skenën kulturore e letrare edhe me të dhëna mbi praktikën e poezisë-miniaturë nga tradita orientale.

Në të vërtetë, siç shënohet në fjalët hyrëse të autorit, publikimi përmban vetëm disa gurë të paçmuar (xhevher) nga “mendimet dhe aforizmat... e udhërrëfënësve bektashinj të vjetër si Gajgusëzi, Nijazi Misërlliu, Nesimi, Pir Sulltani, Viraniu.”

E ndërtuar sipas kriterit alfabetik, vepra përmban kryesisht mendime e aforizma pa metrikë dhe, në një rast të veçantë, shfaqet edhe ndonjë vjershë shoqëruese e metruar, si në rastin e shkronjës “E”, në rrjedhën alfabetike që ndjek botimi:

Im’ atë kur ish atë un’ isha i bir’ i tija;
Nashti: ay një djalë dhe unë prind i tija.³¹

Më herët, po ky autor, sjell dëshmi për njohjen dhe pëlqimin e këtyre formave kur, në një artikull të tij mbi bektashizmin shqiptar, botuar në “Indipendence Shqiptare” në nëntor të vitit 1925, ai shkruan se në banketat (muhabetet) e rregullta të këtyre besimtarëve veshët të dëgjojnë hymne të larta të quajtura “Vefes” dhe “Gazel”.³²

Përmendja e formave poetike të shkurtra të modeleve si *trioleti* dhe *epigrama* dëshmohe në shtypin shqiptar, sikurse provohet, mes të tjerash, nga artikulli i Kristo Floqit me titull *Një vështrim mbi poezinë*.³³ Të dhënat mbi format e tematikës laike plotësohen edhe me njohjen e trioletit me natyrë fetare, të cilat gjenden të botuara edhe te “Kultura islame”, ku, në kronikën mbi veprimtaritë kulturore të zhvilluara në Tiranë, Muharrem Duku shkruan se “para se të fillonte konferenca u morën salevate e u lexuan trioletto Fetare (Qabeja e Madhnuashma) nga një grup nxansish të shkollës fillore, përgadit nga Msuesi i Besimit të këtij qyteti.”³⁴

Duhet shënuar gjithashtu se tradita orientale e strukturave të shkurtra poetike ka qenë e njohur dhe e zbatuar në Shqipëri, si përmes përcjelljes orale

³⁰ Baba Ali Tomori, *Mendime dhe aforizma bektashijsh të vjetër* - përmbledhje dhe përkëthime. Shtypur në Shtyp. “Mbrothësija” Kristo P. Luarasi, Tiranë, 1934.

³¹ Baba Ali Tomori, *Vëllimi II*. Argeta LMG, Tiranë, 2021, f. 260.

³² Shih: Baba Ali Tomori, *Bektashizma turke dhe Bektashizma shqiptare*, Vepra III, Kryegjyshata Botërore e Bektashinjve dhe Argeta LMG, Tiranë, 2021, f. 32.

³³ K. Floqi, “Një vështrim mbi poezinë”, *Hylli i Dritës*, No.11, Shkodër, Nëntuer 1936, f. 530.

³⁴ *Kultura islame*: Rubrika “Të ndryshme”, No-20-21, Tiranë, 1941-1941, f. 206.

të këtyre krijimeve nga poetët-muzikëtarë ashtu si dhe përmes botimeve të bejteve satirike apo gazeleve bektashiane.³⁵

Por modeli i mikropoezisë i ka kapërcyer kufijtë e një burimi të vetëm, për t'u shfaqur si pjesë e kulturës perëndimore, asaj perso-arabe (ku, proverbat metrike, epigramet apo teknika e shkrimit të *bejtes*, *rubaisë*, *gazelit*, rrinë si forma të shkurtra përballë poemave) dhe asaj të lindjes së largme.

Në pikëpamjen e dijenisë kulturore, ushtruar edhe përmes disa praktikave të ardhura si përkthim, disa tipare të poezisë së shkurtër japoneze i janë bërë të dukshme lexuesit të specializuar shqiptar që në mes të viteve '40 të shekullit të kaluar.

I tillë është rasti i përkthimeve dhe i një artikulli informues mbi poezinë japoneze të përgatitur nga Injac Zamputi, në të cilin ndeshim ilustrime të formave të poezisë miniaturë në kulturat e largëta, përfshirë këtu edhe të formave *tanka* dhe *haiku*.³⁶

Këto qëmtime shembujsh sillen këtu për të theksuar se, pavarësisht se tradita letrare në gjuhën shqipe nuk ka qenë mjaftueshmërisht ndikuese përsa i përket poezisë miniaturë, madje përkundrazi, është parapëlqyer dhe është lëvruar balada e poema e gjatë epike, vetë zhanri i poezisë së shkruar në formë të shkurtër; kudo që ky model shfaqet, trashëgon tipare të përbashkëta, të cilat e bëjnë atë t'i kapërcejë kufijtë dhe të ndikojë mbi kulturat.

Janë këto tipare të përbashkëta të cilat lejojnë që ama ushqyese për poetët të jenë traditat vendase dhe pikëtakimet me kulturat e largëta poetike orientale perso-arabe, të cilat e ushtruan ndikimin e tyre në mënyrë të tërthortë, përmes leximeve.

Sidoqoftë, një prani e tillë, e sjellë përmes krijimeve të autorëve apo ndihmesave të përkthyesve dhe përgatitësve të botimeve të lartpërmendura, nuk mund të krijojë rrethanën bindëse për t'u shprehur se në Shqipëri ndeshim një traditë të zhvilluar letrare në shkrimin e formave të shkurtra poetike, prej së cilës mund të krijoreshin modele të qëndrueshme për poetët pasardhës.

Shembujt në fjalë, në përfaqësimet e tyre kryesore, që mbeten brenda formave tradicionale dhe praktikave klasike të vargëzimit, nuk arrijnë të krijojnë një prirje domethënëse lidhur me shkrimin e formave të shkurtra të poezisë.

³⁵ Shih: Dh. Shuteriqi: *Shkrimet shqipe në vitet 1332-1850*, Akademia e Shkencave e RP të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1976.

³⁶ I. Zamputi, "Prej Letërsisë botnore - Disa poezij japoneze", *Leka*, Nr. 8-9, Shkodër, 1943, fq. 249-254.

II

Hyrje në 'Shkurtimat' e Xhevahir Spahiut

Forma e poezisë së shkurtër në krijimtarinë e Xhevahir Spahiut tashmë është bërë e njohur si një nënloj më vete, cilësuar “shkurtimë”, që për nga ana strukturore paraqitet si ndërthurje e teknikave, traditave dhe kulturave të ndryshme të ligjërimit poetik.

Tiparet e këtij ligjërimi të ndërmjetëm, ku bashkëjetojnë ligjërimi burimor, mbartur përmes oralitetit tradicional dhe shkrimësisë letrare, duke bërë që “shkurtima” t’i përngjajë enigmave të vargëzuara, proverbit dhe formave të tjera të traditës shqiptare, po aq sa edhe epigramit poetik, sencencës, monostikut aforistik dhe teknikave të tjera të ngulitjes së shpejtë në të shkruarit e poezisë.

Tipari i shkurtësisë do të ishte krejt formal nëse elementeve të tij nuk do t’i bashkonim edhe ato të kadencave, përfundimit të menjëhershëm dhe pa paralajmërim të poezisë, të kulturës së fragmentit apo dëshmisë së kronikanit, si veçanti të traditës shqiptare, të cilat studiuesi Ali Aliu i vë në lidhje me krijimtarinë e formave të shkurtra të poezisë së Xhevahir Spahiut dhe shkollave jotradicionale. Në një studim të tij, shkruar me rastin e botimit të vëllimeve poetike “Udha”³⁷, ky studiues thekson se “shkurtimat” e Xhevahir Spahiut përfaqësojnë jo thjesht një veçori të stilit të tij, por “vijne si prirje, si risi dhe janë *haiku* origjinal në poezinë shqipe”³⁸.

Vëzhgimi i studiuesit Ali Aliu, dhe sidomos veçimi se shkurtimat e Xhevahir Spahiut janë forma “*haiku* origjinal”, duhet kuptuar jo formalisht, por si vlerë përfaqësimi. Kjo pasi më shumë sesa me teknikat unike dhe standarde të shkrimit të traditës poetike japoneze (organizuar zakonisht 17 rrokje, të ndarë në tre grupe me 5+7+5), përmes pohimit “*haiku* origjinal” shenjohet lidhja e shkurtimave të poetit shqiptar me aspekte të veçanta të haikut.

Tipare të ngjashme mes modelesh e rimodelimesh të shkurtimave me haikun janë të karakterit tematik, të tilla si: qëndrimi i përbashkët subjektiv kundrejt natyrës njerëzore dhe Natyrës si e tillë, vëzhgimi në thellësi i çasteve të veçanta e metafizike të jetës si p.sh.: jeta, vdekja, lindja, vetmia dhe përmallimi, si dhe vëzhgimi e përshkrimi i tyre me mprehtësi e saktësi.

Këto tipare që në të vërtetë po aq sa të *haikut* janë edhe universale, sigurojnë mbështetje të mjaftueshme për t’i cilësuar shkurtimat e Xhevahir Spahiut si “*haiku* origjinal”, qoftë edhe për faktin se *haiku* është forma më e pranishme e poezisë së Lindjes në kulturën perëndimore.

³⁷ Shih: A. Aliu, “Koha e pamposhtur e poezisë”, botuar në vëllimin *Udha 1*, Poeteka, Tiranë, 2000.

³⁸ A. Aliu, *po aty*, f. 19.

Nga ana tjetër, është për t'u shënuar se shkurtimeat e këtij poeti vërtet organizohen përmes artikullimit të një teme të vetme, gjallëruar përmes rimave, asonancave, theksit, aliteracionit e ritmit, dhe jo përmes një numri të paracaktuar rrokjesh a njësisish fonetike, siç organizohet *haiku* dhe *tanka*.

Veç kësaj, fakti se këto shkurtime janë të strukturuar kryesisht në stanca metrike (distikë, kuplete, tercina, kartena, kuintete e sekstete) e jo në monostrofa të çliuara nga modelet e rimimit apo nga metri i rregullt, kthehet në argumentin që, më shumë sesa përkrah traditës aziatike të shkrimit të poezisë-miniaturë, ato rrinë pranë traditës së miniaturës europiane në poezi.

Këto dukuri bëjnë që prurjet e Xhevahir Spahiut në poezinë epigramatike-miniaturë të jenë formalisht pjesë e modelit perëndimor të shkrimit të poezisë dhe jo e traditës lindore të miniaturës poetike.

Gjenealogji dhe kronologji në poezinë miniaturë të Xhevahir Spahiut

Pavarësisht se formën e tyre më të plotë e paraqesin pas viteve '90, sidomos me vëllimet poetike *Kohë e krisur* (1991) dhe *Ferrparajsa* (1994), teknika dhe stilistika e poezisë-miniaturë në krijimtarinë poetike të Xhevahir Spahiut mund të gjurmohet më herët se sa vitet që deri më sot i kemi shenjuar si fillestarë për këtë krijimtari. Gjurmimi në krijimtarinë më të hershme të autorit sjell dëshmi se poezia-miniaturë është e pranishme kohë më parë se Xhevahir Spahiu t'i cilësonte "shkurtime" poezitë e tij. Të dhëna si këto propozojnë një kalendar të ndryshëm mbi fillimet e minipoezisë së këtij autori dhe një tjetër rend kronologjik në zhvillimin e këtij zhanri.

Edhe pa qenë të cilësuar shprehimisht si "shkurtime" – gjë që autori do ta shpallte dukshëm në vitin 1990, përmes një cikli të gjerë poezish epigramatike, botuar në gazetën "Drita", prozodia me tiparet e sentencës dhe epigramit poetik të Xhevahir Spahiu vëzhgohet që në mes të viteve '70-'80 të shekullit të 20-të.

Shenjat më të hershme të pranisë së këtyre strukturave të kufizuara për nga ana e formës ndeshen në poezitë me titull "Histori", "Akuarel" dhe "Në stacion", të cilat u botuan si pjesë e vëllimit "Vdekje perëndive" (1977). Edhe pse termi cilësues "shkurtime" nuk është artikuluar ende, këto krijime kanë tiparet dhe ndjekin rregullat e krijimit të poezisë epigramatike si miniatura.

Për poezitë "Akuarel" dhe "Në stacion", ngaqë nuk u shënohet në mënyrë të shprehur viti i krijimit, referencë kronologjike mbetet vitbotimi i librit, më 1977. Pavarësisht kësaj, duke iu referuar procedurave dhe politikave botuese të atyre viteve dhe kohës së nevojshme që i duhej një dorëshkrimi për t'u shndërruar në libër, ku veç shtypshkrimit, përfshihen edhe procese të tjera si ai i recensave, miratimit, redaktimit, korrektimit teknik e letrar etj., datëkrijimi i këtyre poezive është më së paku një vit më i hershëm.

Ndryshe nga këto, poezia me titull "Histori", botuar në të njëjtën vepër, mban si nënshkrim vitin 1975, duke e shtyrë në dy vjet kronologjinë e fillesave

të poezisë-miniaturë të Xhevahir Spahiut.

Për nga struktura, të tri poezitë janë pesëvargëshe (kuintet) me tipare të ndryshme në praktikën arkitekturore të vargëzimit.

Te poezia “Akuarel”, vargu i tretë dhe i katërt paraqet pasurim të formave vizuale dhe prani të shkuar të faktorit grafik, duke bërë që poezia e shkurtër e Xhevahir Spahiut t’i largohet formave klasike dhe të kërkojë bashkëkohësi në eksperimentin formal, në variacionet e formave të vargjeve dhe përpjekje të spikatura që poezia e tij të merrte edhe formën e artit pamor. Gjithashtu, edhe vargu i pestë dhe i fundit i kësaj poezie krijon origjinalitet përmes thyerjes dhe mbivlerësimit të fjalës-varg përmes teknikës së zhvendosjes dhe përdorimit të asonancës.

Nga vetullat tek buzët,
nga buzët tek sytë:
një lojë dritash,
një pranverë lulesh
lëviz.³⁹

Te poezia “Në stacion” pesëvargëshi realizohet përmes një distiku dhe një tercine, ndërkohë që shkurtima “Histori” është një monostik po me pesë vargje, me lidhje antonimike mes tyre, shkruar si një strofë e vetme e rrjedhshme:

Gjaku pikoi e hodhi rrënjë mbi gurë,
gjakun prej shpatave e fshimë me shajak;
kur s’patëm armë,
ne prej trupit shkulëm
njërën nga brinjët dhe e bëmë shpatë.⁴⁰

Po kështu, edhe në vëllimin “Zgjimi i thellësive” (1979), vepër së cilës iu ndalua shpërndarja, u hoq nga qarkullimi dhe u bë karton, ndeshen disa krijime me tiparet e poezisë miniaturë, epigramit poetik, të tilla si: “Muret e kështjellës” “Mesnatë dimërore”, “Kur ty të shikoj” dhe “Gjerësi”.⁴¹

Gurë pas guri lidhur
me të bardhën e vezës.

³⁹ Xh. Spahiu, “Akuarel”, botuar në *Bota ku eci*, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Tiranë, 2019, f. 20.

⁴⁰ Xh. Spahiu, “Histori”, botuar në *Udha 1*, “Ideart”, Tiranë, 2005, f. 37.

⁴¹ *Po aty*, f. 71, 83, 86, 89.

Njerëzit s'kishin bukë,
Liria kish njerëz.⁴²

Të gjitha këto poezi strukturalisht janë dublete distikësh dramatikë e lirikë, të cilat funksionojnë mbi asonancat fundore dhe që e ruajnë forcën e tyre sentenciale, paradoksale, simbolike dhe alegorike në antinominë e vargut të fundit. Dallim nga ana formale bën poezia “Gjerësi”, e cila përveçse realizohet në distikë, si tri të parat, shton edhe dy elemente të reja: fillimin e secilit distik me pika reticence dhe thyerjen e zhvendosur të vargut të dytë.

... Syri humbet në mjegullnajën e
skajeve - univers blu.

...megjithëse deti është i madh,
pulëbardha duket.⁴³

Por veç poezive-miniaturë, të sipërcituara, në këtë libër gjendet edhe poezia “Pafundësi”, që sipas nënshkrimit të vetë autorit, sjell të dhëna te reja për gjenealogjinë dhe kronologjinë e zhanrit të mikropoezisë të Xhevahir Spahiu.

Pavarësisht se nga ana grafike arkitektura e kësaj poezie ndërtohet mbi gjashtë vargje, thyerja e vargut bën që tercinat të rimodelohen si sekstet. Por vlera e kësaj poezie nuk qëndron përjashtimisht te fakti nëse kemi të bëjmë me një lirikë apo te ndryshimi strukturor a metrik, që e dallon këtë krijim nga poezitë e tjera të shkurtra brenda së njëjtës vepër letrare, të cilat janë dubleta distikësh, por te kronologjia e krijimit, pasi autori e ka nënshkruar si krijimtari të vitit 1971, duke e shtyrë edhe më thellë kronologjinë e fillesave.

Tej maleve të kaltër është deti,
tej ditëve që vijnë është Ajo.

Unë e ndiej,
unë e ndiej,
unë e ndiej
Bukurinë e gjithçkaje që s'shoh.⁴⁴

Kjo e dhënë merr vlerë të veçantë për ngulitjen e një fillese të prirjes së Xhevahir Spahiu ndaj poezisë-miniaturë, duke e zhvendosur kohën e

⁴² *Po aty*, “Muret e Kështjellës”, f. 71.

⁴³ *Po aty*, “Gjerësi”, f. 89.

⁴⁴ *Po aty*, “Pafundësi”, f. 74.

aktivizimit të prirjes pothuajse dy dekada më parë se të shenjohen nga emërtesa kodifikuese “shkurtima” e vitit 1990.

Por prirja për forma jo rastësore të epigramit poetik të Xhevahir Spahiut vijon të jetë e pranishme edhe në librin “Heshtje s’ka” (1989), siç vërehet përmes poezisë “Syri në udhëtim”, një kuintet i ndërtuar në tre monostikë, përmes strukturës kuartet-kuintet.

Përtej dritares
një sy i ndritshëm ylli.
Mos është syri im
shtegtar i hapësirave të largëta?
Nuk di pse më dhembin pak zgavrat.⁴⁵

Me librin “Kohë e krisur” (1991), në të cilin gjendet edhe cikli prej njëzet poezish të botuara në gazetën “Drita”, në numrin e 11 nëntorit të vitit 1990, prirja për shkrimin e mikropoezive ngulitet dhe terminologjia zë vend, duke i njohur “shkurtimat” si pjesë e qenësishme dhe e mëvetme në krijimtarinë poetike të Xhevahir Spahiut. Në to bëjnë pjesë shkurtima që rimarrin thënie nga historia, si shkurtima në vijim: “Për popujt e vegjël / ka fat apo s’ka? Hyjnë e dalin nga dyert e tragjediave të mëdha”, referuar Ismail Qemalit, sikurse ka edhe mjaft të tjera jashtë referencave, të cilat autori i solli për lexuesit në një botim të përzgjedhur.⁴⁶

Duke qenë përzgjedhje, në këtë botim mungojnë disa prej shkurtimave të mëhershme prej ciklit të publikuar së pari në “Drita”, të tilla si shkurtima *Bota*:

Thellë e më thellë sheh bota brenda meje
atë që unë nuk mundem dot ta shoh

e njoh dhe s’e njoh⁴⁷

apo shkurtima *Çast dobësie*:

Ky këtu është batakçi
Ai krah tij më pisi i batakçinjve.
A mundesh tek ‘ta, si tek lumenjtë shkatërrues
Të hetosh ndonjë shpresë drite⁴⁸

⁴⁵ Po aty, *Syri në udhëtim*, f. 180.

⁴⁶ Më hollësisht rreth këtij cikli shkurtimash shih vëllimin *Udha 1*, “Poeteka”, Tiranë, 2000, fq. 241-250.

⁴⁷ Xh. Spahi, “Bota”, botuar në gazetën *Drita* më 11.11.1990.

⁴⁸ *Po aty*.

sikurse edhe *Vjeshhtë e tretë*:

Dëbora pa rënë po shkrihet
Në vend të natës
në vend të çatave,
është zemra,
zemra ime që thinjet⁴⁹

Në këtë vëllim mungon gjithashtu edhe shkurtimea *Vjedhësit e bukurisë*, botuar në “Heshtje s’ka” (1989):

Po njeriut ia morën pëllumbin, degën.

Lindën maskat,
bukurinë e vodhën profetët.⁵⁰

Më pas, përmes krijimtarisë së botuar si shkurtime të “Ferrparajsa” (1994), “Pezull” (1996), “Rreziku” (2003) apo edhe në vëllimin “Vetëtimë” (2013), veçoria strukturohet, duke e klasifikuar dhe përligjur “shkurtimeën” si teknikë shkrimore unike e krijimtarisë së këtij poeti dhe duke ndikuar në kohë edhe te poetë të tjerë, që krijuan nën këtë formë.

***Poezia minimale dhe përkime të saj
me poezitë e shkurtra të Xhevahir Spahiut***

Klasifikimi sipas llojit përgjithësues të këtij lloji të shkrimit poetik plotësohet edhe me atë që terminologjikisht përkufizohet si “poezi minimale”, si pjesë e traditës perëndimore të shkrimit poetik.

Edhe pse e ndikuar nga modele paraardhëse të vetë kulturës perëndimore apo të kulturave të tjera, mes të cilave edhe *haiku*, në vitet ’60 të shekullit të 20-të “poezia minimale” la gjurmën e vet mes rrymave, zhanreve e lëvizjeve poetike moderniste.

Duhet thënë se mes viteve të zbatimit të shkrimit të poezisë minimale dhe gjurmëve të hershme të poezive me pak vargje të Xhevahir Spahiut ekziston një afri formale prej një dekade. Fillimet dhe zhvillimi i poezisë mininale shënohen në vitet ’60 të shekullit të kaluar, ndërkohë që te Xhevahir Spahiu, këto fillesa i gjejmë në vitet ’70, pavarësisht se nuk ishin emërtuar ende si “shkurtime”.

⁴⁹ *Po aty*.

⁵⁰ Xh. Spahiu, *Vjedhësit e bukurisë*, Poezia shqipe, Shtëpia botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1990, f. 182.

Ndër të tillat mund të renditen poezitë e shkruara “Akuarel”, “Histori”, “Në stacion” etj., botuar më pas si pjesë e vëllimit “Vdekje perëndive”, 1977, por që në një përmbledhje të autorit, botuar nga Akademia e Shkencave të Shqipërisë, i gjejmë si pjesë të vëllimit “Bota ku eci”.

Por përkimi në kohë mes “poezisë mininale” dhe “shkurtimave” vetëm sa i paraprin kërkimeve më të thelluara. Përtej anës formale të afrisë në kohë, vlerë marrin disa tipare të përbashkëta, të tilla si lakonizmi, shmangja deri në eliminim të njërive të tepërta leksikore apo përqendrimi i skenës rrëfimore te një pamje e vetme.

Tipare të tjera ngjashmërie mes poezisë minimale dhe shkurtimave të Xhevahir Spahiut vërehen edhe te mungesa e formave të rrëfimit e sidomos mungesa e ndodhive apo të ndonjë personazhi, që do e zgjasnin poezinë, do të shfronësonin e shfuqizonin fjalën e bashkë me këto do të asgjësonin vetë minimalizmin në poezi.

Po kështu, sërish në aspektin formal këto poezi bëhen tipologjikisht të afërta edhe për shkak të faktorit grafik. Poezia shkurtimë, me strukturë minimale e Xhevahir Spahiut, ofron variacione në strukturën e vargjeve, të cilat thyhen, largohen e ndahen si përfaqësime të formave të larmishme vizuale, të cilat lehtësojnë anën përmbajtësore, duke kërkuar, me këtë shkas, jo vetëm theksimin e semantikës, por edhe zgjerim të ndikimit përmes formave të paraqitjes së fjalëve.

Sidoqoftë, sikurse shfaqen afritë, bëhen të pranishme edhe asimetritë mes shkurtimave të Xhevahir Spahiut dhe poezive minimale të ushtruara nga Aram Saroyan apo Richard Kostelanetz-ut etj. Te këta autorë, variacionet pamore, madhësia e shkronjës tipografike apo edhe ngjyrat në vargje apo fjalë të veçanta, arrijnë të ndikojnë, duke luajtur rol kuptimor dhe emocional.

Nga njëra anë ata krijojnë lidhje me dadaizmin, si paraardhës, por dhe pikëtakime me artet pamore, duke e vënë theksin te natyra e fragmentit dhe përvoja e ndërprerë, të cilën kap poezia minimale, si teknika e fokusimit në një objekt të vetëm, vëzhgimet e holla e të përqendruara, larg vargjeve të mbingarkuara me nënkuptime, simbolikë e retorikë, siç theksonte William Carlos Williams, duke bërë që poezia minimale të ishte pjesë e lëvizjeve moderniste në poezi.

Teknika të shkrimit të ‘Shkurtimave’ si mikropoezi

Shkurtimat e Xhevahir Spahiut trashëgojnë nga teknikat shkrimore të epigramit elementin proverbial, mprehtësinë depërtuese, thjeshtësinë në kuptueshmëri, koncizitetin dhe kulturën e ngulitur gramatikore, si gjenetikë me prejardhje nga protoforma e skalitjes së vargjeve në antikitet. Sintaksa e këtyre krijimeve e flijon stilizimin e rafinuar poetik për t’i dhënë më shumë vlerë rendit të ngulitur të fjalëve, duke ua shtuar atyre peshën, si element

drejtpehues, kundrejt mungesës së detyruar të larmisë së rimave apo mjeteve të tjera metrike.

Gjithashtu, është e dallueshme se shkurtimeat e këtij poeti e kanë ruajtur mirë tiparin takigrafik, të stilizuar si një shënim i shpejtë, kapur nxitimthi, si një mëtim për të ndalur lëvizjen dhe për të shpëtuar atë që mund të shpëtohej nga rrjedha e mendimit.

Tipareve të tilla, si shënimi i shpejtë apo kapja e temave nxitimthi, janë vëzhguar gjithashtu edhe nga përkthyesi në frëngjisht i poezisë së Xhevahir Spahiut i cili, tipareve të mësipërme u shtron edhe “situatat urgjente” apo “zhdërvjelltësinë e teksteve”. Në vlerësimin e tij është kjo bashkësi tiparesh që i bën shkurtimeat e këtij poeti “më tërheqëse, me një efekt më të madh” për ta “shndërruar këtë shkurtesë në shenjë të një begatie”, çka dëshmon se Xhevahir Spahiu “zotëron artin për t’i thënë gjërat përmbledhtas, për të shprehur kuintesencën e disa dukurive apo realiteteve historiko-sociologjike, me shprehje sintetike”⁵¹.

Por a është kjo thjesht një formë a një sistem grafik formal, që do ta bënte poezinë të ngjashme me brakigrafinë që, në vend të fjalëve, mban shënim shkurtesat e koduara dhe që ruan vetëm strukturën skeletore të idesë, në vend të mendimit të artikuluar plotësisht?

Falë pasurisë tingullore që poeti organizon, në vend të një shënimi të ngurtë stenografik, leximi i shndërron në fonograma shkurtimeat e Xhevahir Spahiut. Këto shkurtime, si mënyrë e shkrimit frazeografik të poezisë, e kanë forcën te forma e shkurtër, e cila i jep vargut mundësinë të jetë emergjent, mbresëlënëse dhe i paharrueshëm, duke iu nënshtruar ndërkaq edhe përpunimit stilistikor.⁵²

Përmes kësaj mënyre imediate të të shprehurit, çasti i krijimit merr vlerën e një artefakti letrar me karakteristika të veçanta, përshtatur si epigram i mbyllur dhe fragment simbolik, që i mbijetoi përjetimit, siç vërehet nga shkurtime-dëshmi *Në Skuterrë të Tiranës*, shkruar në vitin 1984:

Skëterrë.

Skuterrë.

Skutë e errët?

Hapni dritaret,
ndizni fenerët!⁵³

⁵¹ A. Zotos, cituar sipas artikullit “Xhevahir Spahiu, autor i një poezie me ngarkesë të madhe elektrike”, botuar me titullin “Xhevahir Spahiu, kundër rrymës”, revista *Poeteka*, N. 40, Tiranë, 2016, f. 136.

⁵² D. Philip Lindsley, *The elements of Tachygraphy*, “Wentworth Press”, Sydney, 2019, fq. 3-11.

⁵³ Xh. Spahiu, vëllimin *Udha 1*, “Poeteka”, Tiranë, 2000, f. 56.

Ndërkohë, nga monostiku, kjo poezi ruan trajtat e shprehjes së një mendimi të vetëm, që përpunohet dhe i nënshtrohet disa rregullave metrike, ku mbi të gjitha spikat ritmi i përbërë dhe disa lloje rimash.

Përqendrimi i energjisë krijuese në një pikë të vetme tematike dhe përmbajtësore është një nga tiparet e qenësishme të shkurtimeve të Xhevahir Spahiut, që realizohen falë njohjes së teknikave shkrimore dhe zotërimi i mjeshtërisë. Përveç këtyre, qartësia, lakonizmi dhe virtuozeiteti i improvizimit, bëhen tipare themelore të shkurtimeve të tij.

Duke u përqendruar në tri tipologji modelesh, mund të vërehet se pjesa më e madhe e shkurtimeve janë lirika meditative, që i kushtohen drejtpërsëdrejti peizazhit natyror dhe atij alegorik, të cilat sjellin pamje nga lumi, mali, muzgu që bie, retë, shiu, pjergulla, pemët me fruta, vetëtimat, shelgjet, stinët, zogjtë apo dëborat.

Motive të tjera me rëndësi përbëjnë shkurtime të peizazhit urban dhe të gjendjeve ekzistenciale të njeriut që, në këtë grup shkurtime është edhe më i pranishëm. Pjesa e tretë i kushtohet gjendjeve psiko-emocionale të tilla si ndjenja e zbrazëtisë, zhgënjimi dhe zvetënimi, bjerrja shpirtërore apo vetmia, si në shkurtime të *Dimërim*.

Një perde shiu
më ndan nga bota.
Perdja shpërbëhet
dhe unë sërish
nga bota jam i ndarë⁵⁴

Ky grupim shkurtime kanë si tipar dilemën dhe shpesh përfundojnë me pyetje retorike, si në poezinë me titull *Zezona*:

Ç'mënxyrë ia ul kokën
asaj pishe që s'tundet?

Çdo ditë mbi të një sorrë shkon e ulet.⁵⁵

Në të tri modelimet janë të pranishme e mbinatyrshtëmja, e përtejshmja, e përjetshmja, mistikja dhe e mistifikuara prej poetit, si në poezinë me dy distikë *Monotoni*:

⁵⁴ *Po aty*, f. 243.

⁵⁵ *Po aty*, 345.

Shushurijnë shelgjet në fushë, shushurijnë;
mërmërijnë mizat në mriz, mërmërijnë.

O zot,
lësho një bubullimë.⁵⁶

Këtij grupimi prej tri linjash me motive qendrore i bashkohet ndonjëherë edhe motivi i dashurisë së erotikë apo edhe shprehje e sublimes, si në shkurtime të titull *Rozafë*.

Në të tria këto modelime janë të pranishme dialogët, monologu dhe ndonjëherë edhe ndërthurja mes tyre. Ndonëse jo rrallë shkurtime janë shkruar në varg të lirë, ky i fundit është varg metrik.

Ndërkohë, mjeti stilistikor më i pranishëm mbetet ritmi i rregullt, sinkopat si thyerje asimetrike, kohët e përbëra, që i japin bukuri dhe forcë vargut si dhe rimat e brendshme e të jashtme fundore, ruajtur kryesisht për goditjen përmbyllëse të epigramit poetik, si në rastin e katërvargëshit:

Gjerbon ky shi
gjaku gjerbon
e shi e gjak e gjak e shi
çdo gjerbë një oi⁵⁷

Kjo larmi tematike e stilistikore ndërthuret me prirjen për kërkime formale në vargëzim, përmes të cilave autori eksperimenton me monistikun e thyer si distik (*Historia jonë*), me disa forma tercine pohore (*Mit i rremë; Tomorri; Qyteti pa emër*) dhe pyetëse (*Zezone; Muzg*), më shumë kuartete vargjesh (*Lamtumirë; Ëndërr e re; Kuje botërore; banket në qiell; Kthimi; Në pyllin me sorkadhe; Shtegtimi i zogjve; Ulje çmimesh; Biri i natës; Monotoni, Happy End; Vdekja e lotit*) më rrallë kuintete (*Hëna e vonët; Bisha e bardhë; Vjeshtë e Tretë; Posterënët; Në paralelin Nr...; Vetmitari; Dimërim; Rozafë*) dhe sekstete (*Dy; Harrimi, Pafundësi*).

Elemente të strukturës së ‘Shkurtimeve’

Për nga forma e zbatimit të teknikës, disa nga këto shkurtime janë të organizuara në stanca dhe disa të tjera në strofa. Përmes këtyre kërkimeve autori ka pasuruar format e të shprehurit, duke rritur tensionin emocional. Por, forma të epigramit poetik dhe e lirikës takigrafike nuk janë strukturuar vetëm si monostikë në *shkurtime* të Xhevahir Spahiut. Ato shfaqin larmi, duke u

⁵⁶ *Po aty*, f. 247.

⁵⁷ Xh. Spahi, *Udha 2*, “Poeteka”, Tiranë, 2000, f. 209.

përpunuar në forma të pastra kupleti, tercine, katrene apo një kuinteti a seksteti, brenda shprehjes së të njëjtit mendim⁵⁸, duke mos përjashtuar rastet kur këto forma strukturore ndërthuren. Ndër rastet e shmangies vlen të përmenden poezitë *Historia jonë*, ku dy monostikë të veçuar krijojnë distikun, rasti kur dy monostikë formojnë triptikun, si te shkurtime *Mugz*, rasti kur një distik formon kuintetin, si te poezia *Vjeshhtë e Tretë* apo kur prej një monostiku të vetëm formohet një sekstet.

I pasur në forma është edhe organizimi i stancave apo strofave në vetvete. Ka shkurtime të organizuara në formën 1 + 1 (*Historia jonë*), në formën 3 + 2 (*Rozafë*), 2 + 2 (*Vdekja e lotit*), 3 + 1 (*Fusha me shalqinj*), 2 + 1 (*Zezona*), 4 + 1 (*Posterënet*), 2 + 1 + 1 (*Ulje çmimesh*), 1 + 3 (*Shtegtimi i zogjve*), 1 + 4 (*Vjeshhtë e tretë*). Mes këtyre ka edhe shkurtime monokolonë apo të shkruara vetëm në tercinë, siç është cikli *Mjellmat e liqenit*.

Forca epigramatike e secilës shkurtime zakonisht dhe si rregull i përcillet vargut të fundit, duke i dhënë atij bukurinë shtangëse, por edhe ndriçuese të një vetëtime. Që ta zotërojë të gjithë energjinë poetike poeti përdor kryesisht rimat fundore, asonanca kryesisht të cilat, pavarësisht nga thyerjet e monostikut, janë të puthura, si në rastin e shkurtime *Historia jonë* (Tehut të shpatës kemi ecur rrufë / Pastaj shpata ka ecur mbi ne) apo *Vetmitari* (Katër mure / si katër shkretëtira vertikale / i vetëm midis tyre ti, si beduini / Ulërin musone / ulërin!) apo edhe te *Vdekja e lotit* (Buzë mjerimit / bota kalonte me një qeshje si të Zotit / Unë po qaja / për vdekjen e lotit).

Përveç shkurtimeve me titull të cilësuar, një rast të veçantë për shqyrtim përbëjnë edhe shkurtime pa titull apo që në vend të titullit kanë tre yje. Këto shkurtime, më të rralla se shkurtime e titulluara, të tilla si ato që shprehen me distikët “Prej shpatës dhe shpifjes marr plagë / po s’rrezohem / Përballë bukurisë dhe lotit dorëzohem” apo “Një popull i vrarë do t’ ish më fatzi / po qe se nuk vriteshin dhe poetët e tij” dhe veçanërisht shkurtime, pjesa më e madhe tercina, të botuara në librin “Vetëtime” (2013), janë shpërthime të vërteta dhe të befta mes gjendjeve meditative. Në formë tercine është strukturuar gjithashtu edhe shkurtime me titullin “Art”, botuar në vëllimin “Pezull”, 1996.

Tek tingujt vdes
tek ngjyrat çmendem
tek fjala vdes çmendem përmendem.⁵⁹

Tek kjo shkurtime studiuesi Shaban Sinani vëzhgon vetëflijimin, si tipar jo vetëm i këtij krijimi, por të të gjithë veprës poetike të Xhevahir Spahiut,

⁵⁸ E. Hirsch, *A Poet's Glossary*, “Houghton Mifflin Harcourt”, Boston & New York, 2014, f. 609.

⁵⁹ Xh. Spahiu, *Udha 2*, vep. e cit., f. 64.

vetëflijmij që e ka bërë këtë poet të ndjejë “zërat e stërlashtë të të parëve, fjalët e pathëna të maleve e të lumenjve, simfonitë e detrave dhe krenaritë e ullinjve”⁶⁰.

Poezitë-shkurtima pa titull, siç shprehet Aleksandër Zotos “duken si skicimi apo përvijimi i një teksti të ardhshëm”, “një ligjërim që merr fund nga shpërthimi i tij i beftë” dhe “komentari ose përkthimi i një titulli të nënkuptuar..., i një titulli të lënë mënjanë, që do ta frenonte në vrullin e tij të papërmbajtshëm.”⁶¹

Zbulesë tjetër e rëndësishme në mikropoezitë e Xhevahir Spahiut janë shenjat e pikësimit. Zakonisht ky poet e pajis poezinë e tij me sinjalistikë të sigurt dhe të qartë ku presja është presje dhe pika, pikë, e ku pikësimi merr jo rrallë vlera semantike.

Te shkurtimat, ky poet duket se e ka përdorur të plotë shenjuesin konvencional, që nga presja, pika, pikëpresja, dy pikat, viza e shkurtër bashkuese, apostrofi, vizëzimi i gjatë ndarës, pikëpyetësja, pikëçuditja apo shumëpikëshi të përdorura herë në krye, si në poezinë *Gjerësi* dhe herë në fund të vargut. E tillë është shkurtima-distik “Edhe...Edhe”, me vargjet “Kur më shumë besoja e më pak dyshoja, - e pësoja /Kur më pak besoja e më shumë dyshoja, - përsëri e pësoja”, apo edhe poezia pa titull “Natë pa yll / Humbellë pa skaj /Zot, si rri fill?... Qaj.”

Me shenjë grafike të tri pikave poeti hap dialog me lexuesin, që ky i fundit të kuptojë jo vetëm fjalën, por dhe domethënien e heshtjes dhe nënkuptimitin e heshtimitin. Bashkë me këtë shenjë autori zbulon shenjë e dyshimit e të dilemës. Kjo formë e veçantë e shprehjes së poetit përmes shenjave të pikësimit, mund të interpretohet si strategji metaforike, sidomos për krijimtarinë e botuar prej vitit '71 deri në fund të viteve '80, ku duhet interpretuar jo vetëm vlera e fjalës, por edhe vlera e heshtjes në poezinë e Xhevahir Spahiut.

Këto shkurtima shndërrohen në format më të thjeshta të poezisë takigrafike, shkruar pothuajse në ecje, kur poeti kupton se kumtit i mjaftojnë edhe vetëm disa rrokje, një shenjë pikësimi apo një mendim.

I tillë është rasti i shkurtimës minimale, krijuar në kushtet e domosdoshmërisë jetike, si në rastin e dy vargjeve *Njeriu...! I ziu...!*, shkruar me një largësi e zbrazëti të madhe mes dy fjalëve - kode më vete.

Ky tekst, i përmbush më mirë se sa shkurtimat e tjera të Xhevahir Spahiut, kushtet terminologjike për t'u cilësuar “poezi minimale” apo “poezi minimaliste”.

Me substancë nga tekstet orakullore, që ruajnë diçka nga thelbi i paralajmërimeve, Shkurtimat e Xhevahir Spahiut, edhe kur nuk lexohen me zë

⁶⁰ Sh. Sinani, *Për letërsinë shqipe të shekullit të 20-të*, “Naimi”, Tiranë, 2010, f. 330.

⁶¹ A. Zotos, *vep. e cit.*

të lartë, gdhenden në kujtesë, duke u dhënë atyre mundësinë të bëjnë jetë paralele, mes tekstit të shkruar dhe tekstit të mbartur përmes kujtesës, si një jehonë e oralitetit në kohën e shkrimit postmodern. Ka edhe një tjetër tipar veçues në këtë krijimtari.

Edhe kur referimi i tij etnogjenik, “atdheu i kënaqësisë së humbur”, i adresohet fatalitetit, tragjikes dhe dramatikes një gëzim i qashtër shpërthen në poezitë-shkurtime të Xhevahir Spahiut.

Epizmit, jo rrallë të kërkuar me ngulm në poezinë shqiptare para viteve '90, i kundërvihet gati një hare epikuriane e të jetuarit, por edhe e të mbajturit fort pas jetës dhe elementeve thelbësore e domethënës të saj, siç paraqitet në shkurtime të *Dheu im*, si pjesë e vëllimit poetik “Pezull” (1996):

Mos më zezò,
mos u kthe në shushamë.
Të kam mbajtur,
mbamë!⁶²

Veçoria epikuriane e shkurtimeve të Xhevahir Spahiut është jo fort e zakonshme për poezinë shqiptare para viteve '90. Ajo i kundërvihet modelit, njëlloj siç vetë shkurtime, si formë mes epigramit poetik dhe e lirikës takigrafike, qëndron sfiduese përballë poemës së gjatë të *Realizmit Socialist*, për të mbetur një nga mënyrat më të fuqishme shprehëse të këtij autori dhe si një formë e përveçme e epigramit poetik dhe lirikës takigrafike në poezinë shqiptare.

Krahas shkurtimeve, mund të vihet re edhe prirja se Xhevahir Spahiut nuk krijon shkurtime vetëm në poezi, por edhe disa prej titujve të librave të tij, të tillë si *Heshtje s'ka*, *Ferrparajsa*, *Pezull*, *Rreziku*, *Udha*, *Vetëtimë* etj., janë mirëfilli shkurtime origjinale.

Tipare përbashkuese të 'Shkurtimeve' të Xhevahir Spahiut

Në *Shkurtime*, si forma minimaliste të krijimtarisë së Xhevahir Spahiut, gjenden kodet e konkretësisë, koncizitetit, thjeshtësisë dhe fragmentarizmit që, duke qenë parakushte për shkrimin e poezisë-miniaturë si zhanër, mbeten të tilla edhe për krijimtarinë e tij.

Nëse, pas këtyre cilësimeve, do të nënvizonim disa prej tipareve më të spikatura të poezisë-shkurtime të Xhevahir Spahiut, të cilat do e lidhnin autorin e tyre njëkohësisht me traditat europiane dhe jo europiane, klasike e moderne të “zhanërit” miniaturë, ndër më të domethënësit do të ishte operimi me gjuhën

⁶² Xh. Spahiut, *Udha 2*, vep. e cit., f. 80.

dhe rëndësia e pazakontë që i jepet veçmas secilës fjalë.

Theksimi i pazakontë i fjalës, si e mëvetme, në lidhje, por dhe autonome ndaj njërive të ngjashme në ligjërim, bënë që te Xhevahir Spahiu *Shkurtimat* të shndërrohen në shenja të fuqishme e vetjake, ku ky autori zhvillonin përvoja eksperimentale si të rrafshit gjuhësor, ashtu edhe prozodik.

Pa braktisur atë çka kritika e konsideron si tradicionale apo klasike për metrikën, në poezinë-miniaturë të këtij poeti procesi i kërkimit dhe gjetjes së imazhit rivlerësohet, duke u shndërruar në qëllim, ndërkohë që elementi lojë, në lidhje me ritmet, rimat dhe kadencat, sikurse dhe liria e improvizimit, zgjerohet si kurrë në krijimtarinë e mëparshme të tij.

Mes të tjerave, do të zhvillohej puna kërkimore mbi pjesët e pandryshueshme të ligjëratës, të tilla si përdorimi i parafjalëve, lidhëzave, nyjave, ndajfoljeve, që në poezinë miniaturë të këtij autori kanë prirje të shmangen, duke zënë pak vend, në përligje të kodit gjenetik për të cilin këto *Shkurtima* spikasin, të tilla si konkretësia, konciziteti dhe thjeshtimi.

Po ashtu zhvillim merr edhe puna me shenjat e pikësimit të cilat, në *Shkurtimat* e Xhevahir Spahiut marrin vlerë semantike. Në format e miniaturës së tij poetike ky autor nuk i shpërfill shenjat e pikësimit, por i përfshin ato në vargun poetik jo thjesht me rol sinjalizues, por duke u veshur vlera kuptimore, interpretative e domethënëse.

Vërehet gjithashtu se poezia-miniaturë e këtij poeti sjell pasurim e larmi formash strofike, prej nga përftohen risi që, edhe pse kanë nxitur eksperimentin, nuk i cenojnë vlerat estetike të *Shkurtimave* me një apo dy njësi strofike, kryesisht.

Një tjetër tipar dallues i krijimtarisë së Xhevahir Spahiut në shkrimin e miniaturës poetike është edhe angazhimi i mjeteve stilistikore e metrike të veçanta, mbi të gjitha ritmet dhe modele të ndryshme të vargëzimit përmes rimave jo të ndërlikuara në skemat e tyre.

Elemente të tilla ritmike e rimore, së bashku me vëmendjen e shtuar ndaj fjalës dhe shenjave të pikësimit, bëhen instrumente që poezia-miniaturë e Xhevahir Spahiut të shndërrohet në një hapësirë krijuese ku e habitshmja dhe misteriozja mbijeton, si përvojë që mbartet drejt modernitetit prej traditës vargëzuese të ritualit popullor.

Në qasje e shqyrtim sociologjik mund të vërehet se kjo poetikë, vendosur në kushtet e një shoqërie të re dhe gjithmonë e më laike, ku ekzorçizmi klasik zëvendësohet me ekzorçizmin social, vlera purifikuese në ritualin urban i njihet poezisë, sidomos formave të shkurtra të saj.

Nëse praktikat tradicionale të ritualeve vargëzuese kishin qëllim nxjerrjen e demonëve prej trupit njerëzor, *Shkurtimat* e Xhevahir Spahiut e përdorin ekzorçizmi poetik me qëllim shëlbimin e trupit social. Kjo pasi, siç vëren studiuesi Ali Aliu, “muza poetike e Xhevahir Spahiut nuk ngjizet as nuk shpërthen në truall të butë, aq më pak në truall indiferent.

Duke qenë natyrë krijuese e pasioneve të forta, natyrë e pasioneve të tërësishme, duke qenë natyrë e shquar e guximit krijues e intelektual, kjo natyrë, pra, e shpreh dhe e fortifikon qëndrimin e vet definitiv jetësor, shoqëror dhe njerëzor që në hapin e parë të frymëzimit, diferencohet që në fiksimin e objektit poetik.”⁶³.

Nga pikëpamja formale e të mbajturit shënim, miniaturat poetike të Xhevahir Spahiut shndërrohet në artefakte kulturore e historike, që trashëgojnë tiparet e teknikave të hershme të *njësisë shqiptare*, siç do të shprehej Çabej dhe bënë të vetat *sistemin stenografik* të të shkruarit të teksteve letrare nxitimthi, shkurtazi, por me prani të estetikës, siç vihet re në praktikat moderne ku u zbatua praktika e miniaturës poetike.

BIBLIOGRAFI

Aliu, Ali:

- *Udha e cilësuar*, “Rilindja”, Prishtinë, 28 mars 1981.
- “Koha e pamposhtur e poezisë”, *Udha 1*, Poeteka, Tiranë, 2000.

Ashta, Kolë:

- “Prolusjoni i «Epikës Popullore» në katedrën e Gjuhës Shqipe në Rome nga Prof. E. Koliqi”, *Hylli i Dritës*, No. 3-7, Shkodër, 1939.
- “Ngjyra e vendit të Filip Shiroka”, *Revista Letrare*, No. 5, Tiranë, 15 Prill 1944.

Pratt, William:

The Imagist Poem: Modern Poetry in Miniature. “University of New Orleans Press”, Los Angeles, 2009.

Fishta, Gjergj:

“Rrokull Shqipnisë”, *Hylli Dritës*, No. 4, 1914/4.

Merxhani, Branko:

“Rreth riorganizimit t’one arsimor”, *Demokratia*, Gjirokastër, 19 Mars 1932.

Dračini, Qemal:

“*Vepra poetike e Migjenit*”, *Fryma*, Shkodër, 1944, Nr. 3, f. 110.

Maloki, Kristë:

“A asht poet Lasgush Poradeci?”, *Përpyjekja shqiptare*, No. 18-24, Tiranë, 1938, f. 350.

Çabej, Eqrem:

“Për gjenezën e literaturës shqipe”, *Hylli i Dritës*, No. 3-7, Shkodër 1939, fq. 156-175.

Gjeçov, Konstandini Shtjefni:

Agimi i gjytniis, Shtypshkronja “NIKAI”, Shkodër, 1910.

Logori, Loni:

⁶³ A. Aliu, *Udha e cilësuar*, “Rilindja”, Prishtinë, 28 mars 1981.

- “Epigramë”, *Kalendari kombiar për motin 1928*, Volumi i Njëzetë e Dy, Drejtonjës Lumo Skëndo, Botuarë prej Kristo P. Luarasi, Tiranë.
- Mjeda, Ndre:
Guxo (vjersha për fëmijë), Shtëpia Botonjëse “Naim Frashëri”, Tiranë, 1953.
- Gjylbegaj, Hamid:
 - *Kuvendi i shqiptarit*, Shtypshkronja “Gutenberg”, Tiranë, 1934.
 - *Çikrrime filozofie*, Shtypshkronja “Gutenberg”, Tiranë, 1934.
- Poradeci, Lasgush:
Vepra letrare: Trioleta Mbretëria jonë. “Naim Frashëri”, Tiranë, 1990.
- Bulka, Nonda:
Vepra letrare 3, Shtëpia botuese “Naim Frashëri, Tiranë, 1980.
- Camaj, Martin:
 - *Njeriu më vete dhe me të tjerë*, “Onufri”, Tiranë, 2021.
 - *Vepra 9*, “Onufri”, Tiranë, 2010.
- Shkreli, Azem:
Pagëzim i fjalës, “Rilindja”, Prishtinë 1981.
Këtu – këtje, përmbledhur e përgatitur për botim nga Gaçe Ballo dhe Petro Garo, “Shtypshkronja E. Vassiliadhi”, Stamboll, 1924.
- Steffa, Kostaq:
Epigrame dhe aforizma nga disa njerz të çquar. Shtypshkronja “Teknike”, Tiranë, 1930.
- Tomori, Baba Ali:
 - *Mendime dhe aforizma bektashijsh të vjetër* - përmbledhje dhe përkëthime. Shtypur në Shtyp. “Mbrothësija” Kristo P. Luarasi, Tiranë, 1934.
 - *Bektashizma turke dhe Bektashizma shqiptare*, Vepra III, Kryegjyshata Botërore e Bektashinjve dhe Argeta LMG, Tiranë, 2021.
- Floqi, Krist:
 “Një vështrim mbi poezinë”, *Hylli i Dritës*, No.11, Shkodër, Nënduer 1936.
- Kultura Islame*:
 “Të ndryshme”, No-20-21, Tiranë, 1941-1941.
- Shuteriqi, Dhimitër:
Shkrimet shqipe në vitet 1332-1850, Akademia e Shkencave e RP të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1976.
- Zamputi, Injac:
 “Prej Letërsisë botnore - Disa poezij japoneze”, *Leka*, Nr. 8-9, Shkodër, 1943.
- Spahiu, Xhevahir:
 - *Bota ku eci*, “Akademia e Shkencave të Shqipërisë”, Tiranë, 2019.
 - *Udha 1*, “Ideart”, Tiranë, 2005.

- *Udha 1*, “Poeteka”, Tiranë, 2000.
 - *Udha 2*, “Poeteka”, Tiranë, 2000.
 - *Drita*, 11.11.1990.
 - *Poezia shqipe*, Shtëpia botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1990.
- Zotos, Aleksandër:
“Xhevahir Spahiu, kundër rrymës”, *Poeteka*, N. 40, Tiranë, 2016.
- Lindsley, David Philip:
The elements of Tachygraphy, “Wentworth Press”, Sydney, 2019.
- Hirsch, Edward:
A Poet's Glossary, “Houghton Mifflin Harcourt”, Boston & New York, 2014.
- Sinani, Shaban:
Për letërsinë shqipe të shekullit të 20-të, “Naimi”, Tiranë, 2010.

SUMMARY

THE MINIATURE POETRY IN THE ALBANIAN LANGUAGE AND “ABBREVIATIONS-SHKURTIMAT”, BY XHEVAHIR SPAHIU

By researching the means and techniques of writing, the intersections of the poetic epigram with the lyrical poetry and sketched quickly, almost improvised, kept notes in the form of a meticulous tachygraphic one, through this study explores a particular trend in the poetry of Xhevahir Spahiu.

In contrast to the other poetic structures of the author, “Shkurtimat” enriches not only his creativity but also prosody in the Albanian language. Contrary to what has been noticed, the article proposes another starting calendar for Xhevahir Spahiu's mini poetry as well as another chronological order in their development. The work also follows the author's path of transforming a short and sharp form of expression into a special poetic mini-genre, as well as the transformation of modelling into an aesthetic concept. Everything is put in the frame and the background of a short history of miniature poetry in Albania, to come to the special and rare case of the poet Xhevahir Spahiu.

